

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: Cocrra SH.P.K. – Fushë Kosovë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	02.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **02.04.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Cocrra SH.P.K.** me adresë në **Fushë Kosovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIMI, MONTIMI DHE MIRËMBAJTJA E KAMERAVE PËR NEVOJAT E KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1471-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-019-1-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Cocrra SH.P.K.** me adresë në **Fushë Kosovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIMI, MONTIMI DHE MIRËMBAJTJA E KAMERAVE PËR NEVOJAT E KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1471-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-019-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **27.02.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-1471-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-019-1-1-1**
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Cocrra SH.P.K.** me adresë në **Fushë Kosovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIMI, MONTIMI DHE MIRËMBAJTJA E KAMERAVE PËR NEVOJAT E KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1471-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-019-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **27.02.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **02.04.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

c.) Autorizimi nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi për shitjen e këtij produkti baze që është pjese e këtij tenderi (MAF-Autorizimi duhet të jetë me emër të projektit, numër të prokurimit, adresën elektronike, nr tel etj)-LLOT1 Dhe LLOT 2

1. Sa i përket këtij dokumenti për -, ju njoftojme se njehta eshte kerkese qe per here te pare po kerkohet ne aktivitet te ngjashem, pra sa i perket Furnizim me instalimi i kamerave , dhe si e tille nuk eshte ne dispozicion te Operatoreve Ekonomik, konkretisht Kompanive qe operojne me furnizime, montime instalimit e kamerave,,sipas këtij MAF duhet të ken vetem nje komani e cila sipas specikave qe keni vendosur ne params jan te brendit ENS SECUTIRY dhe si e till eshte shkelje ligjore dhe eshte favozirim I hapur Favorozim I hapur I brendit ENS security, gje qe eliminon konkurence ne lir dhe bie ndesh me me Nenin 7 te LPP-se, pasi qe me kerkesen ne fjale AK nuk eshte duke i trajtuar te gjithë OE ne menyre te barabarte dhe eshte duke e reduktuar apo eliminuar konkurrencen e lire ne mes te Operatoreve Ekonomik.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.1 nuk qëndron. Autoriteti Kontraktues konsideron se do të ishte kufizuese nëse AK nuk do të lejonte autorizimin edhe nga dileri i autorizuar por vetëm nga prodhuesi. Por përderisa AK ka dhënë mundësi për OE potencial që Autorizimin ta ofrojnë nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi kjo nuk mund të ulë konkurrencën dhe nuk është kërkesë kufizuese.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

2. Kërkesa 5Për LLOT 1 Dhe LLOT 2 : Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO

3. ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë);

ISO/IEC 27001-2013 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së 4/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK Informacionit);

Dëshmia 5: Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali;

Sa i perket kekrese se certifikatave ISO 9001-2015 ISO/IEC 27001-2013 Certifikaten ne fjale e posedon nje numer shum I vogel 1 qe ofron sherbime te furnizimit, (apo e ka vetem nje kompani favoizuese e Ak-së) instalimi i kamerave,dhe mimbatje. Por edhe nese ndonje kompani e posedon ateher mund te jete vetem nje e tille ne tere territorin e Republikes se Kosoves, me c'rast ky kriter bie ndesh me Nenin 7 te LPP-se, pasi qe me kerkesen ne fjale AK nuk eshte duke i trajtuar te gjitha OE ne menyre te barabarte dhe eshte duke e reduktuar apo eliminuar konkurencen e lire ne mes te Operatoreve Ekonomik.

Kerkojme nga ju si AK qe ta rishqyrtoni kete kerkese,pra ta eliminoni si kriter qe te eliminohet favoizimi I vetem nje kompanie .

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.2 gjithashtu nuk qëndron, ngase certifikatat e kërkuara janë në konform natyrës së Aktivitetit të Prokurimit në fjalë dhe të njëjtat posedojnë një numër i madh i Operatorëve Ekonomik.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

2.Sipas Specifikave te ngakuara ne system ne platfomen eprokuirmit. : LOT 2 Komplet eshte spcifikimi I vetem nje bredi te caktuar ENS SECURITY si ilushttrim e keni specifikimin dhe linkun me posht/ Favorozim I hapur I brendit ENS SECUTIRY , pasi ne spcifikim dhe modelin e erkuar perkojn me ketLSpecifikacioni për kamerën 1 njejt vlen edhe per NVR 8 channel nvr 32 channel dhe kamera aneksit 2 te gjitha jan ten je breddit gje qe bie ndesh me nien 7 te LPP 4K bullet IP/ Networking Security Camera, 8MP@30FPS,Fixed lens 2.8mm,1/1.2”Night Color,True WDR,Starlight ,video content analytics (VCA), Face Detection (FD), UL Listed professional surveillance products <https://www.worldyecam.com/8-mp-full-color-fixed-bullet-network-security-camerasip48b5l-28-u2.html>

Ne teresi specifkimi Teknik I LLOT 2 kerkuar nga ju eshte komplet favorizim I hapur I bdrendit ENS SECURITY gje qe bie ndesh me nenit Nenin 7 te LPP-se, pasi qe me kerkesen ne fjale AK nuk eshte duke i trajtuar te gjitha OE ne menyre te barabarte dhe eshte duke e reduktuar apo eliminuar konkurencen e lire ne mes te Operatoreve Ekonomik

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Sa i përket specifikave teknike gjatë vendosjes se tyre AK është bazuar në nenin 19.6 të Rregullores për Prokurim Publik duke i përcjellë me fjalët “ekuivalente”.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit